



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 1581 Prot.

Tiranë, më datë 15.11 .2021

VENDIM  
Nr. 633, datë 12.11.2021

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj” dhe VKM Nr. 786, datë 26.12.2018 “Për miratimin e Zonave Arkeologjike “A” dhe “B”, të qytetit të Durrësit dhe të Planit për Ruatjen, Mbrojtjen dhe Administrimin e tyre”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 12.11.2021:

VENDOSI:

1. Shtyrjen e vendimmarrjes për projektin e zbatimit “Restaurimi dhe rikualifikimi urban i zonës perspektive TID të gjendur në Parkun Arkeologjik të Durrësit”, me aplikues dhe projektues “Illyrian Consulting Engineers” sh.p.k., zhvillues AADF, sa i takon rishikimit dhe plotësimit të Projektit të Zbatimit me:

- Konceptin e Sondazheve Arkeologjike/ Gërmimit Arkeologjik, hartuar nga individ/ subjekt i licencuar në veprimtari arkeologjike dhe propozimin për ndërtimin e pavioneve të arkeologjisë, i cili duhet të jetë në përputhje me ndërhyrjet e lejuara në Zonën Arkeologjike “A”;
- Analizën e detajuar të zonës në studim (analizë funksionale, historike, etj.) dhe të fasadave të objekteve brenda kësaj zone;
- Dokumentacionin tekniko – ligjor të objekteve të cilat propozohen të prishen;
- Planin e fazave të ndërhyrjes për zbatimin e projektit;
- Projektin arkitektonik dhe konstruktiv për secilin objekt ku do të ndërhyhet, shoqëruar me elementët arkitektonikë, detaje dhe specifikime teknike, dimensionime të paraqitura në shkallë të lexueshme;
- Propozimin e dhënë për mobilitetin në bulevardin “Epidamn”, i cili nuk është i përshatshëm për lëvizjen e mjeteve të emergjencës dhe ndihmës së shpejtë, si dhe plotësimin me detajet teknike për shtrimet në hapësirat publike;
- Planin e mobilimit urban, tabelat informuese, zonat rekreative dhe variante alternative për modelet e ndriçuesve, shoqëruar me detajet dhe specifikimet teknike;

2. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
3. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**SEKRETAR**  
**Rudina ZOTO**

